

## VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"FORALB ALABASTER" SH.P.K.

Datë: 16 Maj 2012

Sot më datë 16 Maj 2012, në vijim të njoftimit për mbledhje të datës 02/05/2012, protokolluar pranë ortakut Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me Nr. 4217 Prot, datë 02.05.2012, mbledhet Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "FORALB ALABASTER" SH.P.K., e regjistruar në Shqipëri, me seli në Kavaje në adresën: Mengaj, Kavajë, me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT) K62903844I, pranë zyrave të METE-së  
Asambleja e Ortakëve përbëhet nga

**Enea Leoncini** i paisur me kart identiteti nr. AO06796658, që zotëron 75% të kuotave të shoqërisë dhe

**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës** që zotëron 25% të kuotave të shoqërisë, përfaqësuar nga Znj. Gjinovefa Arizaj me kart identiteti nr.024403699, sipas autorizimit nr.4217/1 dt.15/05/2012 të Ministrit të Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës Z. Nasip Naço, i cili përfaqëson qëndrimin e tij sipas shkresës nr.4217/2 dt.15/05/2012 si dhe me cilësinë e mbajtjes së proces verbalit dhe përkthyeses Znj. Albana Ahmeti e paisur me kart identiteti 029860968.

Mbledhja mbahet në zyrën përfaqësues Znj. Gjinovefa Arizaj pranë ambienteve të METE, cila ndodhet në adresën: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë, nga ortaku Enea Leoncini. Axhenda e mbledhjes është:

1. Miratimi i ndryshimit të Statutit në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", përfshire ndryshimet si dhe depozitimim pranë QKR-se
2. Miratimi e pasqyrave financiare të vitit 2011

Ortakët diskutuan dhe pranuan të gjitha ndryshimet e Statutit të shoqërisë, bazuar në ligjin Nr. 9901, date 14/04/2008, "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", si dhe pasqyrat financiare të vitit 2011, miratuar këto dhe me qëndrimin e shprehur nga Ministri i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës me shkresë nr. 4217/2 dt. 15/05/2012 2012,

Ortakët me unanimitet

### VENDOSËN:

1. Të miratojë dhe nënshkruajë Statutin e ri të shoqërisë.
2. Ky Statut zëvendëson të mëparshmin.
3. Rregullimet e këtij Statuti hyjnë në fuqi në datën e depozitimit dhe regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

SH.P.K. Import - Export  
FORALB ALABASTER  
KAVAJE - ALBANIA

Enea Leoncini

Gjinovefa Arizaj

Arizaj

1

✓

4. Miratoi llogaritë dhe pasqyrat financiare për vitin fiskal 2011 që fillon më 1 Janar 2011 dhe përfundon më 31 Dhjetor 2011, në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
5. Fitimi i vitit ushtrimor pas heqjes së rezervës ligjore të shpërndahet dividend për ortakët proporcionalisht sipas përqindjes që zotërojnë në kapital.
6. Enea Leoncini autorizohet dhe ngarkohet të depozitojë kopje të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit brenda një muaji nga data e Vendimit dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, përpara datës 31 Korrik 2012.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### ORTAKËT

Ortaku Italian

Perfaqësuesi i Ortakut shtet


**"Ministria e Ekonomisë, e Tregëtisë dhe Energjitikës**

**Enea LEONCINI**

**Znj. Gjinovëfa ARIZAJ**

Perkthyesja

Albana Ahmeti



Two handwritten signatures in black ink. The first signature is clearly legible as "Gjinovëfa Arizaj". The second signature is more stylized and less legible.

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“FORALB ALABASTËR” sh.p.k.**

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1                      DATA E THEMELIMIT DHE REGJISTRIMIT SI SH.P.K.**

Shoqëria “FORALB ALABASTËR” sh.p.k. është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me anë të Vendimit Nr. 7100 , datë 04.11.1994 te Gjykatës së Rrethit Tirane.

**Neni 2                      ORTAKËT E SHOQËRISË**

Ortakët e Shoqërisë “FORALB ALABASTER” sh.p.k. janë:

1. **Enea Leoncini**, shtetas Italian, i biri Antonios dhe i Anites, lindur më 06.08.1942 në Rocca San Casciano, Forlì, me qëndrim pranë AIRE, Ambasada Italiane, Tiranë.

Dhe

2. **Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës**, sipas përshkrimeve dhe rregullimeve të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”” neni 2 dhe Aktit Normativ Nr. 3, datë 04.04.2004.

**Neni 3                      EMRI, FORMA**

Emri i Shoqërisë është “FORALB ALABASTER” dhe është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 4                      SELIA**



Selia e shoqërisë ndodhet në Kavajë në adresën: Mengaj-Kavaje.

**Neni 5 OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Prodhimi dhe eksportimi i gips, alabaster dhe prodhimeve të tyre, tregëtimi i tyre për vend dhe eksport.

**Neni 6 KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin që ka në objekt, për një periudhë deri me 25 Maj 2027 (dymijeenjzeteshtate).

**KREU II**

**KAPITALI I REGJISTRUAR**

**Neni 7 KAPITALI I SHOQËRISË DHE PSESËT**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 30.980.000 (tridhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë i ndarë në 30.980 pjesë me vlerë 1000 lekë secila.

Pjesëmarrja e ortakeve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

1. Enea Leoncini zotëron 75% të kapitalit të shoqërisë, i cili është kontribut në natyrë, në vlerën 23.234.000 (njëzetë e tremijë e dyqind e tridhjetë e katërmijë) lekë
2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës zotëron 25% të kapitalit të shoqërisë, i cili është kontribut në natyrë, në vlerën 7.746.000 (shtatëmilion shtatëqind e dyzet e gjashtëmijë).

**Neni 8 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejta që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet mënyrave të përcaktuara me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Në rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të transferojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që



oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë, me të njëjtat kushte që do t'i bëhet të tretëve.

## **Neni 9 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë apo zvogëlojë kapitalin e shoqërisë, veprim ky i cili kërkon shumicë të kualifikuar, duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe është i vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të numrit total të votave dhe vendoset me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.

### **Kreu III**

## **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

### **Neni 10. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

#### **1. Funksionimi dhe Kompetencat**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "FORALB ALABASTER" sh.p.k. vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, ndryshimin e statutit, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar, mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecures së veprimtarisë, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, riorganizimin ose prishjen e shoqërisë si dhe çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

#### **2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga legjislacioni, Statuti dhe sa herë mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Në rast se asambleja thirret nga këta të fundit ato mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim për të thirrur asamblenë dhe/ose për përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.



### 3. Vendi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve do të mbahen në një vend brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, siç mund të përcaktohet në çdo kohë nga ortakët. Në qoftë se një vend i tillë nuk është përcaktuar në njoftimin e thirrjes së asamblesë, mbledhjet do të mbahen në selinë e shoqërisë.

### 4. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Asamblesë të Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës të parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas rregulla të përcaktuara në këtë paragraf, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi lëshohet vetëm për një mbledhje të asamblesë, përveç kur mbledhjet vijuese kanë të njëjtën rend dite. Administratorët nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

### 5. Marrja e Vendimeve

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kërkojnë shumicë të zakonshme, janë të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave dhe vendoset me 50 % të votave të ortakëve pjesëmarrës.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kërkojnë shumicë të kualifikuar, si në rastin e ndryshimit të statutit, zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të numrit total të votave dhe vendoset me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo vendim tjetër do të jetë i vlefshëm nëse merret nga shumica e kërkuar nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

### Kreu IV



## ADMINISTRIMI

### Neni 11 EMËRIMI I ADMINISTRATORËVE

Asambleja e Përgjithshme zgjedh Administrator i cili mund të jetë person fizik i zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj. Ai emërohet për një periudhë pesëvjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

Administrator i shoqërisë emërohet Enea Leoncini, i biri Antonios dhe i Anites, lindur më 06.08.1942 në Rocca San Casciano, Forlì, , me qendrim pranë AIRE, Ambasada Italiane, Tiranë.

### Neni 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Pasuria dhe aktiviteti i Shoqërisë do të administrohen dhe drejtohen nga Administratori, i cili mund të ushtrojë çdo kompetencë e mund të kryejë çdo veprim të ligjshëm, në emër të Shoqërisë, me përjashtim të atyre që ligji apo ky Statut ja rezervon Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori përfaqëson Shoqërinë tek të tretët dhe kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë. Në marrëdhënie me të tretët Administratori e angazhon Shoqërinë nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

## Kreu V

### ASPEKTI FINANCIAR

#### Neni 13 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

#### Neni 14 LLOGARITË VJETORE

Llogaritë vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe nëse do të jetë rasti nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

#### **Neni 15                      DIVIDENTI**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin proporcionalisht me përqindjen e pjesëmarrjes së gjithsecilit në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në përpjestim me pjesëmarrjen në shoqëri, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 16                      PRISHJA**

Prishja e Shoqërisë mund të bëhet për arsyet e përmendura në ligj dhe për çfarëdolloj arsyeje që e vështirëson apo bën të pamundur vazhdimin e aktivitetit të saj.

Prishja e Shoqërisë do të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili merret dhe është i vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të numrit total të votave dhe vendoset me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.

#### **Neni 17                      LIKUJDIMI**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që ne momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një likuidator, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

#### **Neni 18                      LIGJI I ZBATUESHËM DHE INTERPRETIMI**



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen rregullimet e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti do të zgjidhet nga gjykata kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Nëse ndonjë rregullim i këtij Statuti, pas fillimit të zbatimit të tij, do të bëhet objekt diskutimi, ai rregullim duhet të interpretohet duke u bazuar në frymën e përgjithshme të Statutit.

## ORTAKËT


Ortaku Italian

Përfaqësuesi i Ortakut shtet

"Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës"

Enea LEONCINI

Znj. Gjinovefa ARIZAJ



Sl. 16/duaj/2012

Beledinaj pe e kaan peritokyer us  
Allanaj Hereti

## VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

**"Foralb Albastër" SH.P.K.**

**Datë: 16 Shtator 2016**

Sot më datë 16.09.2016, e premte ora 10.30 , u mbledh asambleja e përgjithshme e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Foralb Albastër" sh.p.k.**, e cila mbahet pranë ambienteve të shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë. Kjo mbledhje u mbajt në vijim të njoftimit për thirrjen e Asamblese së Ortakëve nga administratori i shoqërisë në datën 06 Shtator 2016 protokolluar pranë Ministrisë së Zhvillimit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me Nr. 7299 Prot, dt 07/09/2019 dhe njoftuar dhe nëshkruar nga ortakun tjetër Alesio- 2014 shpk po në dt. 07.09.2016. Shoqëri kjo e regjistruar në Shqipëri, me seli në Mengja, Kavajë me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT: J62903844I

Asambleja e Ortakëve përbëhet nga

**Enea Leoncini** i paisur me kart identiteti nr. A006796658, që zotëron 29.99% të kuotave të shoqërisë

**Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes**, si ortak i 25% të kuotave përfaqësuar nga Znj. Gjinovefa Arizaj me kart identiteti nr.024403699, sipas autorizimit nr 7299/1prot dt. 15/09/2016 të Ministrisë së Zhvillimit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes Znj. MILVA EKONOMI, e cila përfaqëson qëndrimin e saj sipas shkresës nr.7299/2 prot dt. 15/09/2016.

**Alesio-2014 shpk** me NIPT L41713003M përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 45% të kuotave të shoqërisë

Me cilësinë e mbajtjes së proces verbalit dhe përkthyeses Znj. Albana Ahmeti e paisur me pasaporte me BA3368434

Mbledhja mbahet në selinë e shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë, nga ortaku Enea Leoncini. Axhenda e mbledhjes është:

- Miratimi e shtesës së objektit të veprimtarisë të shoqërisë, në statut, dhe akt themelimi si më poshtë:

**Nxjerrja, shfrytëzimi dhe përpunimi i produkteve të alabastres, gips dhe materialeve të tjera jo metalore, prodhimin e tregtimin me pakicë e shumicë të prodhimeve të ndryshme prej druri,eksport-import të materialeve të ndryshme, artikujve të ndryshem industriale, etj. Veprimtari dhe shërbime të tjera të lejuara nga ligji.**

Ortakët diskutuan dhe miratuan shtesën e objektit të veprimtarisë së shoqërisë , e cila është miratuar edhe me qëndrimin e shprehur nga **Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes** me shkresë nr. 7299/2 dt. 15/09/2016

Ortakët

### VENDOSËN:

Miratimin e shtesës së objektit të veprimtarisë së shoqërisë, në statut dhe akt themelimi si më poshtë:

**Nxjerrja, shfrytëzimi dhe përpunimi i produkteve të alabastrës, gips dhe materialeve të tjera jo metalore, prodhimin e tregtimin me pakicë e shumicë të prodhimeve të ndryshme prej druri,eksport-import të materialeve të ndryshme, artikujve të ndryshem industriale, etj. Veprimtari dhe shërbime të tjera të lejuara nga ligji.**




1. Enea Leoncini autorizohet dhe ngarkohet të depozitojë kopje të këtij vendimi pranë Z. Enea Leoncini me cilesin e administratorit të kryeje procedurat pranë QKB-se , sipas rregullave në fuqi
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT

Ortaku Italian

**Enea LEONCINI**

*Enea Leoncini*  


Ortaku

**Alesio-2014 shpk**


Anton Gjinaj

*Anton*



Mbajtësja e proces-verbalit të mbledhjes dhe perkthyesja

Albana Ahmeti

*Albana Ahmeti*  


Përfaqësuesi i Ortakut shtet  
**"Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë  
dhe Sipërmarrjes  
Znj. Gjinovefa ARIZAJ**

*Gjinovefa Arizaj* 

